



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 188, datë 28.05.2020

PËR

HAPJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARIT PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.

II. Afati i kandidimit

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

4. Në procedurën e ngritjes në detyrë sipas këtij vendimi mund të konkurrojë çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë.
5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si mëposhtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
 - b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
 - c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :
- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Dokumentacioni sipas pikës 6, të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. Procedura e kandidimit

8. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, kandidatët i nënshtrohen procesit të verifikimit të plotësimin të kritereve ligjore të kandidimit sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.
9. Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:
- a) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, për kandidatin në një pozicion në sistemin gjyqësor;
ose
 - b) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për

në Gjykatën e Lartë”, për kandidatin në një pozicion të komanduar, i cili nuk ka vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë ku është i komanduar.

10. Për kandidatët e kualifikuar me vendim përfundimtar sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, zbatohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VETËDEKLARIM
PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

Lëshuar më _____.____.2020

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më _____.____.2020

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)

(Nënshkrimi)